

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06
**Prokurori kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit,
Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit**

Për: Gjykatësin e Procedurës Paraprake
Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Parashtrues: Mbrojtësi i specializuar i Hashim Thaçit

Data: 14 dhjetor 2020

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Kërkesë e përbashkët e Mbrojtjes për ndryshimin e afatit për parashtrim të
mocioneve paraprake**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hashim Thaçit

Dejvid Hupër

Mbrojtësit të Kadri Veselit

Ben Emmerson

Mbrojtësit të Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtëses së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

I. HYRJE

1. Më 12 dhjetor 2020, Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) përfundoi nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(1)(a). Mbrojtja për katër të akuzuarit paraqet kërkesë të përbashkët për ndryshim të afatit standard prej tridhjetë ditësh të përcaktuar në rregullën 97(2) të Rregullores së Procedurave dhe Provave (RRPP). Duke mbajtur parasysh sasinë e konsiderueshme të materialeve që duhen nxjerrë, pikat ligjore komplekse që duhen trajtuar si dhe rrethanat konkrete të çështjes, ekzistojnë arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit.

II. HISTORIKU PROCEDURAL

2. Në *vendimin kornizë mbi nxjerrjen e provave dhe çështje lidhur me to*, të datës 23 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës Paraprake caktoi të premtën, 11 dhjetor 2020, si afatin përfundimtar që ZPS-ja të përfundonte nxjerrjen e materialit sipas rregullës 102(1)(a).¹
3. Më 11 dhjetor 2020, Mbrojtja mori 1309 dokumente potencialisht shfajësuese, sipas rregullës 103 të RRPP-së.² Më 12 dhjetor 2020, Mbrojtja u njoftua për 1760 dokumente në mbështetje të Aktakuzës, sipas rregullës 102(1)(a) të RRPP-së.³

III. PARASHTRIME

4. Rregulla 9(5)(a) e RRPP-së i jep kompetencë Gjykatësit të Procedurës Paraprake për zgjatjen e afateve të përcaktuara në këtë Rregullore “nëse paraqiten arsye të vlefshme”.

¹ KSC-BC-2020-06/F00099, para 56.

² Nxjerrja e materialit 8.

³ Nxjerrja e materialit 9 dhe 10.

5. Afati prej 30 ditësh i përcaktuar në rregullën 97(2) është i përgjithshëm dhe nuk u referohet rrethanave konkrete të çështjes, që përfshijnë aspekte si numri i të akuzuarve, fushëveprimi i akuzave dhe sasia e materialit që duhet shqyrtuar. Duke pasur parasysh nevojën për përshtatjen e afateve me rrethanat konkrete të çështjeve individuale, zgjatjet e afateve për dorëzimin e mocioneve paraprake kanë qenë të zakonshme, fakt që pasqyron për shembull, caktimin në moment të fundit të mbrojtësve për shumicën e të akuzuarve; rëndësinë e mocioneve paraprake për një gjykim të drejtë dhe të shpejtë si dhe rëndësinë për “këshillim të plotë” me klientin para “ndërmarrjes së një hapi kaq domethënës si mocioni paraprak”.⁴
6. Në rastin konkret, këshillimi i plotë me të akuzuarin është më i vështirë për shkak të masave të vendosura për trajtimin e pandemisë, në vazhdimësi, nga KOVID-19. Aktualisht për takimet juridike me personat në paraburgim (‘NJP’) lejohen vetëm dy vizitorë njëherësh, duke përfshirë përkthyesin, dhe kryhen përmes lidhjes telefonike dhe të ndarë me një dritare. Krahas kësaj, mbrojtësit përballen me kufizime për udhëtimet, çka i bën të vështira vizitat në Hagë. Alternativa për dhënien e udhëzimeve përmes videolidhjes ka rezultuar alternativë e dobët. Nxjerrja e materialit për të paraburgosurit, qoftë shkresa, ose në formë elektronike, është kufizuar për shkak të rregullave që u forcuan edhe më tej nga

⁴ *Prosecutor v. Karadžić*, IT-95-5/18-PT, Decision in Respect of Motion for Extension of Time, 30 March 2009; *Prosecutor v. Krajisnik*, IT-00-29, Order for Extension of Time, 31 May 2000; *Prosecutor v. Zigić*, Decision on Defence Motion to Extend the Time Limit for Submitting Preliminary Motions, 24 June 1998; *Prosecutor v. Strugar*, IT-01-42-PT, Decision on Motion by the Defence for an Extension of Time, 28 December 2001. *Prosecutor v. Drjlaka & Kovacević*, IT0-97-24, Order Granting Request for Extension of Time to File Preliminary Motion, 30 September 1997, *Prosecutor v. Zigiranyirazo*, ICTR-2001-73-1, Decision on the Defence Request for Extension of Time to File Preliminary Motions under Rule 72(G) of the Rules of Procedure and Evidence, 17 December 2003; *Prosecutor v. Gatete*, ICTR-2000-61, Decision on the Defence Motion concerning Defects in the Amended Indictment, 3 July 2009; *Prosecutor v. Setako*, ICTR-04-81-I Decision on the Defence Motion concerning Defects in the Amended Indictment, 3 March 2008; *Prosecutor v. Strugar*, IT-01-42-PT, Decision on Motion by the Defence for an Extension of Time, 28 December 2001, para. 3: “është gjithmonë një veprim i zgjuar që mbrojtësi të këshillohet plotësisht me klientin para se të ndërmarrë një hap aq domethënës si mocioni paraprak me hollësitë që përfshin ky proces”.

KOVID-19. Kjo çështje po zhvillohet në rrethana të jashtëzakonshme, të cilat favorizojnë zgjatje të afatit për të përgatitur parashtrime të tilla.

7. Në këtë rast, afati 30-ditor përfshin edhe pushimin dimëror të Dhomave të Specializuara të Kosovës (“DHSK”), që është nga 21 dhjetor deri më 1 janar 2021, periudhë gjatë së cilës ka tri ditë pushimi zyrtar të Gjykatës.⁵ Megjithëse periudhat e pushimit të Gjykatës dhe festat zyrtare nuk janë një arsytim më vete për pezullimin ose shtyrjen e afateve,⁶ ato duhen mbajtur parasysh në shqyrtimin e kërkesës në fjalë, pasi logjikisht, anëtarët e ekipeve të Mbrojtjes nuk do të mund të punojnë gjatë orarit normal të punës.⁷

⁵ Kalendar i pushimeve të DHSK-së, gjendet në: <https://www.scp-ks.org/en/calendar>. *Shih gjithashtu Ligjin Nr. 03/L-064 “Për festat zyrtare në Republikën e Kosovës”, neni 2.1: “Duke pasur parasysh respektimin e historisë, kulturës dhe të traditave, të popullit të Kosovës dhe të shtetasve të saj, festa zyrtare në Republikën e Kosovës janë: a) Viti i Ri, 1 dhe 2 janari [...] h) Krishtlindjet (Katolike) – 25 dhjetor; i) Krishtlindjet (Ortodokse) - 7 janar”. Shih gjithashtu nenin 4: “Kur ditët e festave zyrtare të cekura në nenin 2 të këtij ligji bien ditën e shtunë ose të diel, ditë pushim do të jenë ditët pasardhëse të punës.” Në vitin 2021, data 2 janar bie ditë e shtunë. Gjendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2539>*

⁶ Rregulla 123(3) e RRPP-së: “Gjatë periudhave të pushimit të përcaktuara nga Kryetari sipas rregullës13(1)(d), përveçse kur është vendosur ndryshe nga trupi gjykues, seancat mbahen vetëm për çështje të ngutshme dhe afatet nuk pezullohen.”

⁷ *Prosecutor v. Katanga & Ngudjolo*, ICC-01/04-01/07 (OA), Decision in support of the “Prosecutor’s Urgent Application for Extension of Time to File Document in Support of Appeal, 18 December 2007: “Kjo javë është e pazakontë, mbi të gjitha për faktin se bie gjatë pushimit trejavor të Gjykatës, ka dy ditë festash zyrtare dhe ditë leje të posaçme. Për këtë arsye, duke marrë parasysh këta faktorë, Dhoma e Apelit gjykon se është e përshtatshme të shtyhet afati kohor i parashikuar”; *Prosecutor v. Banda*, ICC-02/05-03/09 OA 5, Decision on Mr. Banda’s request for extension of time for filing a document in support of the appeal, 24 December 2014, para. 6: “Dhoma e Apelit merr parasysh argumentin e paraqitur nga Z. Banda se afati kohor për dorëzimin e dokumentit në mbështetje të apelit bie në periudhën e pushimeve të gjyqësorit, periudhë gjatë së cilës anëtarët e ekipit të tij të mbrojtjes nuk janë në dispozicion për të punuar. Në rrethana të veçanta të rastit në fjalë, Dhoma e Apelit gjykon se, lidhur me këto parashtrime, është paraqitur “arsye e vlefshme”. *Prosecutor v. Bemba*, ICC-01/05-01-08, Transcript, 3 December 2010, p. 31, lines 14-15: “Siç jeni në dijeni, periudha e pushimit të gjykatës fillon në 18 dhjetor 2010 dhe përfundon më 9 janar 2011, duke e përfshirë edhe këtë datë. Kjo ndërprerje nuk ndihmon vetëm gjykatësit dhe Dhomën të pushojnë, por edhe Mbrojtjen”; *Prosecutor v. Lukić & Lukić*, IT-98-32/1-A, Decision on Milan Lukić’s Motion Seeking Extension of Time to File Appeal Brief and Motion for Stay of Proceedings, 30 October 2009, para. 12: “veçanërisht për shkak të numrit të kufizuar të personelit gjatë pushimit dimëror.”

8. Dorëzimi i mocionit paraprak është një hap procedural domethënës në procesin gjyqësor. Në më shumë se një rast, lidhja midis mocioneve paraprake dhe “drejtësisë themelore dhe procesit të rregullt” ka bërë që këto mocione të dorëzoheshin edhe pse “kishte kaluar prej kohësh afati 30-ditor”.⁸ Me rëndësi themelore është aftësia e Mbrojtjes për të dorëzuar parashtrime të cilat analizojnë në mënyrë gjithëpërfshirëse këto pika qendrore, por që në të njëjtën kohë nuk vonojnë procedurat në mënyrë të papërligjur.
9. Lidhur me këtë pikë, është gjithashtu e rëndësishme që DHSK-ja ende nuk ka vendosur në lidhje me asnjë mocion paraprak për mosnjohjen e juridiksionit ose për mangësi në formën e aktakuzës, që do të thotë se Mbrojtja nuk mund t’i referohet jurisprudencës së Gjykatës për këto aspekte. Rrjedhimisht, për përgatitjen e mocioneve paraprake nevojitet një analizë e thelluar e praktikave nga gjykata të tjera, çka kërkon më shumë kohë. Për të njëjtat arsye, shtyrja e afatit kohor nuk do të shërbejë si precedent për çështje të ardhshme gjyqësore, pasi do të jenë zgjidhur shumë nga vështirësitë që ka gjasa të lindin gjatë këtyre çështjeve të para.
10. Megjithatë, më e rëndësishme është sasia e materialit që duhet analizuar dhe diskutuar me të akuzuarin për përgatitjen e mocionit paraprak. E thënë thjesht, nevojitet kohë të lexohen, analizohen dhe të jepen udhëzime për 1760 dokumente në mbështetje të Aktakuzës. Mekanizmi aktivizues në rregullën 97(2) të RRPP-së, ndërmjet përgatitjes së mocionit paraprak dhe nxjerrjes së materialit sipas rregullës 102(1)(a), pasqyron të drejtën e të akuzuarit për të analizuar materialin mbështetës para se të japë udhëzime, mbi bazën e të cilave mund të dorëzohen mocione paraprake në emër të të akuzuarit. Ekzistojnë arsye të vlefshme për

⁸ *Prosecutor v. Stanišić & Simatović*, MICT-15-96-T, MICT-15-96-T, Decision on Motion for Further Particularisation of the Prosecution’s Case, 2 May 2018, para. 13; ; *Prosecutor v. Turinabo et al.*, MICT-18-116-PT, Decision on Motions for Extension of Time to File Preliminary Motions, 14 December 2018 në f. 2.

ndryshimin e afatit mbështetur në kërkesën në fjalë, e cila është dorëzuar paraprakisht në kohë të mjaftueshme për t'i mundësuar Gjykatësit të Procedurës Paraprake "kohë të mjaftueshme për marrjen e vendimit në lidhje me kërkesën para përfundimit të afatit përkatës" në përputhje me rregullën 76 të RRPP-së.

IV. MASA QË KËRKOHET

11. Për arsytet e përmendura më sipër, Mbrojtja kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

TË KONSTATOJË se ekzistojnë arsye të vlefshme sipas rregullës 9(5)(a) për ndryshim të afatit përcaktuar në rregullën 97(2) dhe të

TË URDHËROJË që çdo mocion paraprak sipas rregullës 97(2), të dorëzohet deri më 10 shkurt 2021.

[Numri i fjalëve (original): 1684]

Me respekt,

/nënshkrimi/

Dejvid Hupër

Mbrojtës i specializuar i

Hashim Thaçit

/nënshkrimi/

Ben Emerson CBE QC

Mbrojtës i specializuar i

Kadri Veselit

/nënshkrimi/

Dejvid Jang

Mbrojtës i specializuar i

Rexhep Selimit

/nënshkrimi/

Venkatesvari Alagenda

Mbrojtëse e specializuar e

Jakup Krasniqit

E hënë, 14 dhjetor 2020

Në Londër, Britani e Madhe

Në Hagë, Holandë

Në Kuala Lumpur, Malajzi